

VENDIM
Nr. 106, datë 26.6.2019

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SANG 1” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2 gema “d” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 10, pikat 1 dhe nenit 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 26.6.2019, mbasi shqyrtoi relacionin plotësues të për gatitur me nr. 51/10-1, datë 20.6.2019, në vijim të relacionit të diskutuar më herët në mbledhjen e bordit, nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi licencimin e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, Bordi i ERE-s në vijim të relacionit plotësues me nr. prot 51/10-1 prot, datë 20.6.2019:

konstatoi se:

- Shoqëria “SANG 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr.124 prot., datë 6.2.2019, dhe nr. 124/1 prot., datë 14.2.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në mbledhjen e bordit të ERE-s të datë 31.5.2019, shoqëria “SANG 1” sh.p.k., e cila kishte aplikuar për licencim në të aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit, me vendimin nr. 83, u licencua dhe në veprimtarinë e prodhimit të energjisë nga HEC “Thirrë”.

- Në mbledhjen e bordit të ERE-s të datës 31.0.2019 u kërkuar që të sqarohet me shoqërinë “SANG 1” sh.p.k., në një seancë dëgjimore, vlera financiare e vënë në dispozicion për secilën veprimtari, pasi ajo e deklaruar nga shoqëria “SANG 1” sh.p.k., nuk rezulton e mjaftueshme për të dy veprimtaritë.

- Në seancën dëgjimore të datës 10.6.2019, përfaqësuesit e shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., deklaruan se shuma e deklaruar do të shërbejë për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “SANG 1” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germa “a”, “b”, “c”, “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë e shoqërinë “SANG 1” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti